



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.531/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Vllastimir Dimiq dhe Nehat Idrizi, anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër komisionerve në vendvotimin 1102b/160 për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 15.12.2010, mori këtë:

VENDIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV).

ARSYETIMI

Më datën 13.12.2010 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LVV në të cilën theksohet se me datën 12.12.2010 në ora 16:45 në QV 1102b/160 në shkollën fillore Migjeni, lagja Tamnik në Mitrovicë një person ka votuar dy herë. Pas reagimit të gjithë vëzhguesve nuk janë marrë në konsideratë nga komisionerët e vendvotimit të lartcekur.

Ne mbështetje të pretendimeve parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë prove materiale.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) parashohin si vijon:

3.6 (c) Hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi të gjitha shkresat e lendes gjeti se:

-ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstaton se ankesa është e pabazuar për faktin se nuk i përmban elementet e detyrueshme të parashikuara në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së dhe elementet e parashikuara në nenin 3.6 pika c) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, për shkakun se parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë provë materiale si dëshmi. Për këto arsye dhe bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 531/2010 më datën 15.12.2010

